



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË**

Nr. Prot. 2742 datë 10.06.2020

AGJENCIA E TRAJTIMIT TË KREDIVE

Nr. Prot. 1581 datë 08.03.2020

MARRËVESHJE

MIDIS

BANKËS SË SHQIPËRISË

DHE

AGJENCISË SË TRAJTIMIT TË KREDIVE

**“PËR RAPORTIMIN NË REGJISTRIN E KREDIVE, TË INFORMACIONIT NË LIDHJE ME
PORTOFOLIN E KREDIVE TË ADMINISTRUAR NGA AGJENCIA E TRAJTIMIT TË
KREDIVE”**

TIRANË

PREAMBULA E MARRËVESHJES

Banka e Shqipërisë në rolin e autoritetit mbikëqyrës të bankave dhe degëve të bankave të huaja, si dhe të subjekteve financiare jobanka, të licencuara për ushtrimin e veprimtarive bankare dhe/ose financiare në Republikën e Shqipërisë në bazë të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, i ndryshuar "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", ushtron në mënyrë të vazhdueshme dhe të pavarur mbikëqyrjen e kujdesshme, ndaj këtyre subjekteve. Ushtrimi i funksionit mbikëqyrës nga Banka e Shqipërisë, për subjektet bankare dhe financiare jobanka që ajo licencon, ka për mision të sigurojë veprimtarinë e shëndoshë bankare dhe/ose financiare, në harmoni të plotë dhe në zbatim të kuadrit ligjor e rregullativ përkatës, me qëllim parandalimin e shfaqjes së problemeve që mund të çenojnë qëndrueshmërinë financiare të këtyre subjekteve dhe mbrojtjen e depozituesve. Gjithashtu, funksioni dhe përgjegjësitë mbikëqyrëse, ushtrohen për të parandaluar situatat në të cilat problemet e shfaqura në subjekte të veçanta të mbikëqyrura, mund të shndërrohen në një kërcënim potencial për stabilitetin e sistemit financiar dhe veçanërisht të atij bankar.

Qëllimit të lartpërmendur i shërben dhe mbajtja dhe administrimi i Regjistrit të Kredive nga Banka e Shqipërisë, i cili është sistemi që trajton dhe shpërndan informacionin e regjistruar në të, në funksion të ushtrimit të procesit të mbikëqyrjes dhe administrimit optimal të rrezikut të kredisë nga subjektet e mbikëqyrura prej saj.

Ligji organik nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" i ndryshuar, përcakton si një nga detyrat më të rëndësishme të Bankës së Shqipërisë, përmirësimin e kushteve monetare dhe kredituese, në mbështetje të stabilitetit dhe të zhvillimeve ekonomike të vendit. Në funksion të përmbushjes së kësaj detyre ligjore, krijimi i Regjistrit të Kredive, nëpërmjet trajtimit të përqendruar të informacionit që përpunohet në të në lidhje me kredimarrësit dhe ekspozimin kreditor, veçanërisht ndaj sistemit bankar, përmirëson kushtet për identifikimin, monitorimin dhe administrimin e rrezikut të kredisë, me qëllim reduktimin e tij për çdo subjekt të mbikëqyrur dhe për sistemin bankar në tërësi, si dhe ndikon në rritjen e efikasitetit të kredidhënies.

Krijimi i Regjistrit të Kredisë si dhe kompetencat e Bankës së Shqipërisë lidhur me mbajtjen, funksionimin dhe administrimin e tij, sanksionohen në ligjin nr.9662, datë 18.12.2006 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar (si më poshtë referuar për thjeshtësi si "ligji për bankat"), si dhe në aktet nënligjore të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë në bazë dhe për zbatim të tij.

Gjithashtu, në përputhje me nenin 127, pika 8 e ligjit për bankat, në regjistrin e kredive raportojnë dhe subjekte të tjera financiare që nuk mbikëqyren nga Banka e Shqipërisë, në përputhje me marrëveshjet përkatëse të lidhura ndërmjet kësaj të fundit dhe këtyre subjekteve dhe/ose autoriteteve të tyre rregullatore".

Nën këtë drejtim, me qëllim përmirësimin e funksionimit të Regjistrit të Kredive nëpërmjet pasurimit të informacionit të mbajtur dhe administruar në të, është arritur konsensusi dhe

shprehur vullneti i ndërsjellë dhe i përbashkët, për bashkëpunimin midis Agjencisë së Trajtimit të Kredive, (këtu e në vijim Agjencia) dhe Bankës së Shqipërisë si administratore e Regjistrit të Kredive, për lidhjen e kësaj marrëveshjeje, e cila do të formalizojë përfshirjen në Sistemin e Regjistrit të Kredive të informacionit për kreditë që Agjencia ka, në lidhje me kreditë e subjekteve të ndryshëm të transferuara nga bankat me kapital tërësisht shtetëror tek kjo agjenci.

Në funksion të sa më sipër, lidhet dhe nënshkruhet kjo marrëveshje nga palët e mëposhtme:

1. Banka e Shqipërisë me adresë: Sheshi "Skënderbej" nr.1, Tiranë, (më poshtë referuar si "Banka e Shqipërisë") përfaqësuar nga Zv/Guvernator i Dytë: Zj. Natasha Ahmetaj, si dhe
2. Agjencia e Trajtimit të Kredive, (më poshtë referuar si "Agjencia") me adresë: Rr. Sami Frashëri, ish Drejtoria e Tatimeve, Tiranë, përfaqësuar Drejtori i Përgjithshëm Z.Eri Koshaj.

KREU I

TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Objekti i kësaj marrëveshjeje është përcaktimi i kushteve, të drejtave dhe detyrimeve ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe Agjencisë, për raportimin pranë Sistemit të Regjistrimit të Kredive, të informacionit për kreditë që Agjencia ka, në lidhje me kreditë e subjekteve të ndryshëm, të transferuara nga bankat me kapital tërësisht shtetëror tek kjo agjenci.

Neni 2

Qëllimi

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është dhënia e të drejtës ndaj Agjencisë për raportimin e informacionit dhe të dhënave për ekspozimin kreditor të çdo kredimarrësi si dhe për personat e lidhur me ta, në rastet kur disponohet si informacion, në funksion të regjistrimit, përpunimit dhe shpërndarjes së këtij informacioni në sistemin e Regjistrimit të Kredive, për qëllimet e parashikuara në rregulloren e funksionimit të tij.

Neni 3

Baza Ligjore

Kjo marrëveshje hartohet në përputhje me aktet ligjore dhe/ose nënligjore të mëposhtme:

- a) Ligji nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- b) Ligji nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë"; i ndryshuar;
- c) Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale";
- d) Ligji nr. 8894, datë 14.05.2002, "Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive", i ndryshuar;
- e) Rregullorja nr.67, datë 13.10.2010 "Mbi përmbajtjen e informacionit dhe funksionimin e Regjistrimit të Kredive në Bankën e Shqipërisë"; si dhe
- f) Akteve të tjera nënligjore të Bankës së Shqipërisë.

Neni 4 **Përcaktimet**

1. Termat e përdorur në këtë marrëveshje janë në përputhje me termat e përcaktuar sipas nenit 4 të rregullores nr.67, datë 13.10.2010 "Mbi përmbajtjen e informacionit dhe funksionimin e Regjistrit të Kredive në Bankën e Shqipërisë".

Për qëllime të kësaj marrëveshjeje:

- a) **Banka e Shqipërisë**, është autoriteti përgjegjës për administrimin e sistemit të Regjistrit të Kredive në përputhje me ligjin nr. 9662, datë 18.12.2006, i ndryshuar "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë" si dhe rregulloren nr.67, datë 13.10.2010 "Mbi përmbajtjen e informacionit dhe funksionimin e Regjistrit të Kredive në Bankën e Shqipërisë" (*këtu e më poshtë në këtë marrëveshje do të quhet "Rregullorja e funksionimit të Regjistrit të Kredive"*) dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë dhe për zbatim të tij;
 - b) **Agjencia e Trajtimit të Kredive**, është personi juridik publik, i krijuar me ligj të veçantë i cili në bazë të nenit 2 dhe 10, të ligjit nr. 8894, datë 14.05.2002, i ndryshuar "Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive", trajton kreditë dhe asetet e tjera, të transferuara nga bankat tregtare të nivelit të dytë, me kapital tërësisht shtetëror;
 - c) **Kredimarrës** është çdo individ, person fizik ose juridik, kredia e të cilit është transferuar nga bankat tregtare të nivelit të dytë, me kapital tërësisht shtetëror.
2. Çdo kusht ose formulim i kontratës që mund të sjellë paqartësi, do të interpretohet në kontekstin e tërësisë së rregullores së funksionimit të Regjistrit të Kredive, në frymën e preambulës së kësaj marrëveshjeje, dhe në këndvështrimin e përmbushjes së qëllimit për të cilin është lidhur kjo marrëveshje nga palët.
 3. Për të gjitha çështjet që nuk përcaktohen shprehimisht në këtë marrëveshje, aplikohen rregullat e përcaktuara në Rregulloren e funksionimit të Regjistrit të Kredive si dhe në Udhëzimin Nr.68, datë 13.10.2010 "Për procedurën e nxjerrjes së Raportit mbi Kredimarrësin dhe rishikimin e të dhënave që mbahen në Regjistrin e Kredive".

NENI 5 **Autoriteti Përgjegjës**

Banka e Shqipërisë është autoriteti përgjegjës për administrimin e Regjistrit të Kredive dhe ushtron të gjitha të drejtat dhe funksionet e përcaktuara në rregulloren "Për Regjistrin e Kredive".

KREU II

RAPORTIMI

Neni 6

Raportimi i informacionit dhe të dhënave në Regjistrin e Kredive

1. Agjencia raporton në Regjistrin e Kredive, informacionin dhe të dhënat e përcaktuara sipas kësaj marrëveshjeje për çdo kredimarrës, kreditë e të cilit janë transferuar nga bankat tregtare të nivelit të dytë me kapital tërësisht shtetëror, në përputhje me ligjin nr. Ligji nr. 8894, datë 14.05.2002 "Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive", i ndryshuar.
2. Informacioni i mbajtur në Regjistrin e Kredive për çdo kredimarrës, raportohet në përputhje me formatin e raportimit të informacionit në Regjistrin e Kredisë, sipas nenit 8 të Rregullores së funksionimit të Regjistrit të Kredive dhe shpërndahet sipas formatit të përcaktuar në aneksin 1 bashkëlidhur marrëveshjes.
3. Të gjitha ekspozimet të cilat do të raportohen nga Agjencia pranë Regjistrit të Kredive, do të mbajnë klasifikimin e statusit 4, si "Kredi të Humbura".
4. Në rastet kur kredimarrësi ka shlyer të gjitha detyrimet e pretenduara nga Agjencia, klasifikimi i kredisë do të përditësohet me klasifikimin e statusit 5, si "Kredi e paguar".

Neni 7

Afatet dhe periodiciteti i raportimit

Raportimi i të dhënave të kredimarrësve, mbi gjendjen e portofolit të tyre si dhe cdo ndryshim në marrëveshjet e kredisë së transferuar Agjencisë me debitorin, sipas dispozitave të parashikuara në Ligjin nr. 8894, datë 14.05.2002, i ndryshuar "Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive, do të raportohen pranë Regjistrit të Kredive brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve të para të punës, të muajit pasardhës.

KREU III

PËRPUNIMI I INFORMACIONIT NË REGJISTRIN E KREDIVË DHE KONFIDENCIALITETI I TË DHËNAVE

NENI 8

Përgjegjësia për saktësinë e informacionit dhe të të dhënave

1. Agjencia e cila raporton informacion dhe të dhëna në përputhje me nenin 6 të kësaj marrëveshjeje, është përgjegjëse për saktësinë dhe plotësinë e informacionit dhe të të dhënave të raportuara.
2. Nëse Agjencia, zbulon se ndonjë prej informacioneve ose të dhënave të raportuara janë të pasakta ose të paplota, njofton menjëherë Bankën e Shqipërisë, kryen korrigjimin e informacioneve ose të të dhënave të pasakta apo të paplota, dhe i raporton ato përsëri në Regjistrin e Kredive.
3. Nëse Banka e Shqipërisë vëren kryesisht se informacioni dhe të dhënat e raportuara apo të ruajtura në Regjistrin e Kredive, janë të pasakta apo të paplota, Agjencia duhet të verifikojë arsyet e pasaktësisë apo të paplotësisë, të marrë të gjitha masat e nevojshme për korrigjimin e menjëhershëm të informacionit apo të të dhënave të pasakta, si dhe të informojë Bankën e Shqipërisë lidhur me arsyen që ka shkaktuar raportimin e informacionit të pasaktë ose të paplotë.
4. Agjencia, nëpërmjet akteve të saj të brendshme përcakton procedurat e raportimit të të dhënave për kredimarrësit, procedurat për korrigjimin e të dhënave të pasakta ose të paplota, si dhe procedura të tjera që gjykohen të nevojshme.
5. Banka e Shqipërisë ka të drejtë të pezullojë aksesin e Agjencisë në Regjistrin e kredisë, nëse kjo e fundit nuk merr masat e nevojshme sipas pikës 3 të këtij neni, apo refuzon të trajtojë kërkesën e Bankës së Shqipërisë për rishikimin apo korrigjimin e të dhënave, që mund të jenë të pasakta apo të paplota.

Neni 9

E drejta për të njohur, përpunuar dhe përdorur informacionin e Regjistrit të Kredive

1. Për qëllime të zbatimit të kësaj marrëveshjeje, të drejtat që Agjencia do të ketë në Sistemin e Regjistrit të Kredive, do të jenë vetëm në rolin si **"Raportues"** i të dhënave /informacionit në lidhje me identitetin, gjendjen e kreditit dhe ekspozimin kreditor të të gjithë kredimarrësve.
2. Të drejtën për të njohur, përpunuar dhe përdorur informacionin që raportohet nga Agjencia në Regjistrin e Kredive, e kanë të gjithë *"raportuesit e tjerë të të dhënave"* dhe përdoruesit e autorizuar të tyre. Kjo e drejtë ushtrohet në përputhje me përcaktimet e Rregullores së funksionimit të Regjistrit të Kredive si dhe aktet e tjera nënligjore të Bankës së Shqipërisë mbi bazën e të cilit mbështetet administrimi dhe funksionimi i këtij sistemi.
3. Informacioni dhe të dhënat e raportuara dhe mbajtura në Regjistrin e Kredive në bazë të kësaj marrëveshjeje, përbëjnë sekret bankar e për rrjedhojë përdoruesit e autorizuar të këtij informacioni kanë detyrimin për ti trajtuar dhe ruajtur si të tilla.
4. Këto të dhëna ruhen dhe administrohen në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në rregulloren e funksionimit të Regjistrit të Kredive në Bankën e Shqipërisë.

Neni 10

Miratimi i raportuesve të autorizuar në sistemin e Regjistrit të Kredive

1. Raportimi i të dhënave nga Agjencia, pranë Regjistrit të Kredive të Bankës së Shqipërisë, do të bëhet nga persona të autorizuar nga kjo e fundit për këtë qëllim.
2. Për miratimin e raportuesve të autorizuar, Agjencia plotëson formularin sipas aneksit nr.2 bashkëlidhur kësaj marrëveshjeje, dhe e dërgon për miratim pranë Bankës së Shqipërisë, duke parashtruar dhe arsyen përkatëse.

Neni 11

Kohëzgjatja e mbajtjes së informacionit dhe e të dhënave në Regjistrin e Kredive

1. Banka e Shqipërisë mban në Regjistrin e Kredive informacionin dhe të dhënat e raportuara, për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh nga data në të cilën kredia është raportuar sipas pikës 4, neni 6 të kësaj marrëveshjeje.
2. Pas përfundimit të afatit të lartpërmendur, informacioni dhe të dhënat negative fshihen nga Regjistri i Kredive.

KREU IV

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 15 Publikimet

Në përputhje me parashikimet e rregullores së funksionimit të Regjistrit të Kredive, Banka e Shqipërisë mund të publikojë informacionin dhe të dhënat e raportuara në Regjistrin e Kredive sipas kësaj marrëveshjeje për qëllime kërkimore, statistikore, dhe në shërbim të procesit mbikëqyrës, mbi baza të konsoliduara dhe duke garantuar anonimatën e tyre, pa veçuar raportues të dhënash ose kredimarrës të caktuar.

Neni 16 Angazhimi i palëve

Palët marrin përsipër detyrimin për zbatimin e përmbajtjes së kësaj marrëveshjeje si dhe për respektimin e ndryshimeve të herëpashershme që mund t'i bëhen marrëveshjes, me pëlqimin e ndërsjellë të palëve.

Neni 17 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Palët respektojnë legjislacionin shqiptar në fuqi dhe përpiqen që mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë zbatimit të marrëveshjes, t'i zgjidhin me mirëkuptim midis tyre.
2. Pala që gjykon se ekziston një mosmarrëveshje, njofton palën tjetër me shkrim duke bërë një përshkrim të plotë të çështjeve që kërkojnë zgjidhje.
3. Personat e autorizuar të palëve të përfshira në mosmarrëveshje duhet të bëjnë personalisht apo nëpërmjet përfaqësuesve të tyre përpjekje për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, mbi parimin e ruajtjes së vazhdimësisë së bashkëpunimit për qëllime të të cilit është lidhur marrëveshja.
4. Nëse përfaqësuesit e palëve apo personat e autorizuar të tyre nuk janë në gjendje të zgjidhin mosmarrëveshjen, brenda 14 (katërmëdhjetë) ditësh nga marrja e njoftimit apo për një kohë më të gjatë të miratuar nga palët, njëra palë njofton palën tjetër se çështja nuk është zgjidhur.

5. Në rast mospërbushjes nga Agjencia të kushteve të kësaj marrëveshje, akteve ligjore dhe nënligjore të cilat rregullojnë funksionimin e regjistrit të kredive, si dhe detyrimit për ruajtjen e sekretit për informacionet e marra nga Regjistri i Kredive, Banka e Shqipërisë ka të drejtë të zgjidhë marrëveshjen, si dhe të ndërpresë menjëherë aksesin e Agjencisë në Regjistrin e Kredive.

NENI 19

Kohëzgjatja dhe ndryshimet

1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët dhe do të shtrijë efektet e saj për një periudhë kohe të pacaktuar.
2. Kjo marrëveshje mund të ndryshohet vetëm duke njoftuar paraprakisht me shkrim palët nënshkruese dhe me konsensusin e palëve mbi ndryshimet e propozuara.

Neni 20

Anekset

Anekset Nr.1, Nr.2 bashkëlidhur kësaj marrëveshjeje janë pjesë përbërëse e saj.

BANKA E SHQIPËRISË

Zj.Natasha Ahmetaj

Zv/Guvernator i Dytë



AGJENCIA E TRAJTIMIT TE KREDIVE

Z. Eri Koshaj

Drejtore i Përgjithshëm

